



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	10.02.2022
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-28516/22
<b>Për/ Za/ To:</b>	Shoqata për kthimin e Shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-28516/22 nga Shoqata për kthimin e Shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta, me të cilën kërkohet shfrytëzimin i hapësirës publike në sheshin "Skënderbeu" me datë 14.02.2022 nga ora 12:00 13:00.

Qëllimi i kërkesës shënim i 32 vjetorit të kësaj shoqate ku do të bëjë hapjen e fotoekspozitës me moton "Përjetësisht në memorien Shqiptare".

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin shoqatës për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet për shfrytëzimin i hapësirës publike në sheshin "Skënderbeu" me datë 14.02.2022 nga ora 13:00 me qëllim të shënimit 32 vjetorit të kësaj shoqate ku për shkak të pandemis aktiviteti do të mbahet me një banderolë me foto të aktiviteteve të shoqatës.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parshme.

**Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.**